



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**UDHËZIM  
Nr. 2 Datë 27. 10. 2006**

**PËR  
NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 241, DATË 21. 11. 2005 "PËR  
RREGJISTRIMIN E NJOFTIMIT TË VEPRËS PENALE DHE TË EMRIT TË PERSONIT  
QË I ATRIBUOHET VEPRRA PENALE"**

***Me synim,***

- për të forcuar ligjshmërinë në regjistrimin e njoftimit të veprës penale në prokurori, si dhe;
- për të shmangur problemin e evidentuar në praktikën e zbatimit të këtij udhëzimi, lidhur me afatin e verifikimit të disa njoftimeve të veprës penale.

***Në mbështetje,*** të nenit 24 pika 4, 287 e vijues të K. Pr. Penale dhe nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**UDHËZ O J:**

1. Në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21. 11. 2005 "Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale", pas pikës 2,1 shtohet pika 2.2 me këtë përmbajtje:

"2.2 Në raste të veçanta, kur megjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar - në pikën 2.1 të sipër për aiendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementëve thelbësorë të faktit dhe/ose të elementëve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit, të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marr me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 20 ditë"

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë prokurorët, ndërsa për të kontrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e të gjithë niveleve të prokurorive.

3. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve dhe punonjësit e caktuar për mbajtjen e regjistrit të procedimeve.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë,

**PROKURORLI PËRGJITHSHËM**

**THEODHORI SOPELAKU**



